

**AKT – THEMELIMI  
( KONTRATE)  
I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE  
KUFIZUAR**

**“BIG TRENI” SH.P.K.**

Shoqeria “**BIGALB GROUP**” shpk. Person Juridik shqiptar i rregjistruar si i tille prane Regjistrimit Tregetar ne QKR, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli ne *Tirane*, e perfaqesuar nga Administratori **Vullnet SINAJ**, i biri i Ruzhdiut, i dtl. 24.08.1965, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. Naim Frasheri, lagjia 9, pall.47, shk.2, ap.29. Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr.027971456 leshuar me 08.12.2009, ka vendosur:

**Neni 1**

Te themeloj nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar veprimtarine ekonomike e emeruar “**BIG TRENI**” Sh.p.k. me ortak te vetem Shoqerine “**BIGALB GROUP**” Sh.p.k..

**Neni 2**

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres te derdhur ne kapitalin themelor.

**Neni 3**

Shoqeria e ka seline e saj ne *Tirane, Blv.Zogu i I-re, kati perdhe i godines 9-kateshe te Shoqerise “Agimi”*.

Shoqeria ka te drejte te krijojte brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesi, dege, si dhe ti suprimoje ato.

**Neni 4**

Shoqeria do te kete nje kohezgjatie me nje kufi te pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te ortakut te vetem.

**Neni 5**

Kapitali fillestar themelor i Shoqerise do te jete **3.000.000 leke (tre milion)**, kapital i cili eshte i formuar teresisht nga ortakut i vetem themelues i saj. Kuotat e kapitalit jane te ndara ne **100 pjese te barabarta me vlere nominale 30.000 (tridhejte mije) leke sejcila**.



### Neni 6

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine Tregtare do te shenohet dhe kapitali i derdhur nga ortakut.

Rritja e kapitalit te ortakut nuk eshte e kufizuar.

### Neni 7

Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane shlyer dhe nenshkruar totalisht nga ortakut i vetem i Shoqerise.

### Neni 8

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:

- Import - eksport , tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice si :
- Tregtim artikuj te ndryshem industriale .
- Tregtim artikuj te ndryshem ushqimore .
- Tregtim artikuj te ndryshem bujqesore e blegtorale.
- Tregtim fruta - perime .
- Tregtim pije alkolike te ndryshme.
- Tregtim konfeksione te ndryshme per te rritur dhe femije.
- Tregtim prodhimesh kozmetike e estetike .
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit
- Tregtim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.
- Tregtim, montim, riparim paisjesh elektro - shtepiake , elektronike , elektrike , kompjuterike , higjeno - sanitare dhe hidraulike , prodhime qeramike , artizanati , paisje zyresh etj.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh , motelesh, diskotekash, lojra argetuese per femije , qender sportive , qendra pushimi e kurative .
- Tregtimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregtimin e tyre me pakice .

### Neni 9

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne mbeshtetie te ligjit Nr. 7961, date 12.07.1995 ( Kodit te Punes ), si dhe akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij.

### Neni 10

Ortakut i vetem nuk kufizohet ne rritjen e kapitalit te shoqerise .

### Neni 11



Shoqeria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku i vetem themelues mbart rrezikun e veprimtarise se Shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne Shoqeri.

#### Neni 12

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te shoqerise midis punonjesve brenda saj, si dhe me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, ceshtia mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### Neni 13

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit te saj

#### Neni 14

Organet e shoqerise "**BIG TRENI**" Sh.p.k. jane:

Ortaku i Vetem i shoqerise .

Administratori i shoqerise .

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoqerise.

Administrator i shoqerise do te jete **Z. Vladimir LLESHI**.


Modalitete per ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqerise, ligji 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare" si dhe ligji Nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit "

Ky Akt - Themelim eshte perpiluar ne kater kopie me vlere te njejte me originalin.

*Date, 07 PRILL 2014*

**THEMELUES :**

**Shoqeria " BIGALB GROUP" Sh.p.k.**

  
\_\_\_\_\_

**STATUT**  
**I SHOQERISE TREGTETARE ME PERGJEGJESI TE**  
**KUFIZUAR**

**“BIG TRENI” SH.P.K.**

Shoqeria “**BIG TRENI**” Sh.p.k. eshte e krijuar mbi bazen e Akt-Themelimit te Ortakut te vetem, Shoqerise “**BIGALB GROUP**” shpk. Person Juridik shqiptar i rregjistruar si i tille prane Regjistrimit Tregetar ne QKR, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli ne Tirane, e perfaqesuar nga Administratori **Vullnet SINAJ**, i biri i Ruzhdiut, i dtl. 24.08.1965, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. Naim Frasheri, lagjia 9, pall.47, shk.2, ap.29. Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr.027971456 leshuar me 08.12.2009, i cili ka vendosur te perpiloje kete Statut si me poshte:

**Neni 1**

**EMERTIMI**

Shoqeria eshte quajtur “**BIG TRENI**” Sh.p.k.

Ajo eshte nje person juridik Shqiptar, e cila do te ushtroje aktivitet privat ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë pas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR).

Shoqeria “**BIG TRENI**” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj( Akt - Themelimi dhe Statuti).

Ortaku i vetem themelues ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoj te ardhura, qe mund te vijne nga ushtrimi i veprimtarise private, si dhe te perballoj humbjet deri ne kufirin e vlefes se derdhur ne kapitalin themelor.

**Neni 2**

**OBJEKTI**

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete :

- Import – eksport , tregetin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve , me shumice dhe pakice si :
- Tregetim artikuj te ndryshem industriale.
- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore.
- Tregetim artikuj te ndryshem bujqesore e blegtorale.
- Tregetim fruta - perime .
- Tregetim pije alkolike te ndryshme.
- Tregetim konfeksione te ndryshme per te rritur dhe femije.
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike .
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit
- Tregetim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.
- Tregetim, montim, riparim paisjesh elektro - shtepiake , elektronike , elektrike , kompjuterike , higjeno - sanitare dhe hidraulike , prodhime qeramike , artizanati , paisje zyrash etj



- Hapje dhe shfrytezim hotelesh , motelesh, diskotekash, lojra argetuese per femije , qender sportive , qendra pushimi e kurative .
- Tregetimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, paisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregetimin e tyre me pakice .

### Neni 3

Per kryerien e veprimtarise se saj Shoqeria do te hapi njesi grumbulluese, perpunuese, sherbimi e tregetimi, duke bashkepunuar me persona fizike ose juridike, vendas ose te huaj .

### Neni 4

#### SELIA

Shoqeria e ka seline e saj ne **Tirane, Blv.Zogu i I-re, kati perdhe i godines 9-kateshe te Shoqerise "Agimi"**. Ajo ka te drejte te krijojte renda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, dege, filiale, agjensi, si dhe ti suprimoje ato.

### Neni 5

#### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria Tregetare Private "**BIG TRENI**" Sh.p.k. do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike me nje kufi te pacaktuar e mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe per cfaredo shkak.

### Neni 6

#### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqerise eshte **3.000.000** (tre milion) leke, e perbere nga kuota e ortakut te vetem themelues. Kapitali themeltar i shoqerise eshte formuar teresisht dhe nenshkruar nga themeluesi i saj **Shoqeria "BIGALB GROUP" Sh.p.k. me ortak te vetem Z. Vullnet SINAJ**. Kuotat e kapitalit jane te ndara ne **100 pjese te barabarta me vlere nominale 30.000 (tridhjete mije) leke sejcila**.

### Neni 7

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve. Te gjitha pjeset e kapitalit te Shoqerise mund t'u kalojne, t'u transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne ortakeri, por gjithmone me vendim te ortakut te vetem dhe me akt noterial .  
Trashegimtari hyn ne Shoqeri me te gjitha te drejtat e ortakut dhe me te gjitha efektet.

### Neni 8





Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali themelor, dhe te tjera te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise tregtare. Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortakut i vetem i shoqerise .

#### Neni 9

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike te Shoqerise do te administrohet nga ortakut i vetem . Nje pjese te ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyej te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve .

#### Neni 10

### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NE SHOQERI

Organi vendimor jane vendimet e ortakut te vetem qe zevendeson Asamblene e Ortakeve. Ortaku i vetem ka te gjitha te drejtat qe ka Asambleja e Ortakeve. Ortaku i vetem vendos per ceshtje te tilla si, shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndryshimet ne Statut, zvogelimi i kapitalit themelor ose zmadhimi i tij, transferimi i pjeseve te kapitalit themelor tek te tretet, te veprimtarise se Shoqerise apo likujdimi i saj, shnderrimi i Shoqerise ne nje forme tjeter te parashikuar nga ligji, ndryshimi i vendndodhjes se selise, si dhe shtimi apo pakesimi i objektit te aktivitetit te shoqerise.

#### Neni 11

Ortakut i vetem mbledhiet e zakoneshme i ben cdo vit brenda kater muajve, nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te Shoqerise

#### Neni 12

### ADMINISTRATORI

Administratori qendron per nje periudhe 5 (pese) vjecare ne detyre. Mandati i tij mund te jete i rinovueshem. Ortaku gezon te drejten ne cdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij. Administratori mundet ne cdo moment te emeroje nje zevendes, ta revokojte dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij. Administratori ka keto kompetenca:  
Zbaton planet dhe llogarite ekonomike pas vendimarrjes se ortakut te vetem ne baze te objektit te aktivitetit te shoqerise.  
Perfaqeson shoqerine ne marrdheniet me te tretet, etj.

#### Neni 13

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE DHE REZERVA E DOMOSDOSHME



Cdo vit financiar fillon me 1 Janar te cdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor, me perjashtim te vitit te pare, ku si fillim eshte data e regjistrimit te shoqerise.

#### **Neni 14**

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret, apo nga ekspertet kontabel miratohen nga ortaku i vetem. Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3 - mujor , te mbylljes se vitit financiar .

#### **Neni 15**

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit, por mund te krijoje edhe fonde te tjera.

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhies se sigurimeve shoqerore, etj Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane bankave te vendit dhe te kryej veprime likujdimi me to .

#### **Neni 16**

### **MARREDHENIET E PUNESIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE**

Marredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen nepermjetkontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne perputhje me ligjin Nr. 7961, date 12.07.1995 ( Kodi I Punes ), si dhe legjislacionit tjeter shqipetar qe ben fjale per punesimin .

#### **Neni 17**

Marria ne pune behet me regjistrimin nga punedhenesi ne librin e punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku ushtron veprimtarine Shoqeria .

#### **Neni 18**

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes, per shkelie disiplinore, ose me vete kerkesen e te interesuarit .


largimi nga shoqeria behet mbasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku i vetem themelues .

#### **Neni 19**

Shoqeria mund te lidhi kontrata me sektore shteterore, si dhe me persona fizike ose juridike, vendas ose te huaj.

Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga ortaku i vetem i saj, ose nga nje person tjeter i autorizuar prej tij me prokure .

Te drejtat e detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine .



**Neni 20**

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishies se saj. Per kryerien e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe i paraqesin ortakut te vetem dhe administratorit rezultatet perfundimtare te likujdimit. Ne perfundim ortakut i vetem vendos per heqien e mandatit te tyre . Te gjitha detyrimet qe dalin nga likujdimi, ortakut i vetem i merr persiper per ti shlyer me kapitalin e tij.

**Neni 21**

Te gjitha mosmarreveshiet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te kalojne ne kompetence te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane .

**Neni 22.**

Transferimi i Shoqerise nga nje forme ne nje tjetet behet me vendim te ortakut te vetem, kur plotesohen kushtet per krijimin e Shoqerive te llojeve te tjera .

**Neni 23**

Themeluesi i Shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne Statut dhe ne aktin e themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore ne cdo kohe , me nenet e pershkruara ne kete Statut .  
Ndryshimet e plotesimet behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti .

**Neni 24**

Ceshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete statut , gjithshka i referohet ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare" si dhe ligji Nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", legjislacionit shqipetar ne fuqi, si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre .


**Neni 25**

Ky statut eshte perpiluar dhe firmosur ne kater kopje me vlere te njejte me origjinalin.

*Date, 07 Prill 2014*

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

Shoqeria "BIGALB GROUP" Sh.p.k.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



emri/emërime

**Sinaj**

emri/emërime

**Vullnet**

qytetësi/nacionaliteti

**Shqiptare/Albanian**

qytetësi/nacionaliteti

**Selenice, Vlore**

data e lindjes/date of birth

**24-08-1965**

data e rikthimit/date of issue

**08-12-2009**

autoriteti i shprehur/authority

**MB**

nr. i identifikimit/id no.

**027971456**

qytetësi/nacionaliteti

**M**

data e skadencës/date of expiry

**07-12-2019**

nr. personal/personal no.

**G50820205C**



shprehur/authority

*qytetësi/nacionaliteti*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE  
NOTERE ALBANA HODAJ  
Cel: 068 20 20 790



Nr. 533 Rep.  
Nr. - Kol.

### VERTETIM NENSHKRIMI

Vertetohet se sot me date 07/04/2014(dy mije e katermbedhjete),une Notere **Albana HODAJ**, asistova ne nenshkrimin e akteve bashkengjitur nga shtetasi :

**Vullnet SINAJ**, i biri i Ruzhdiut, i dtl. 24.08.1965, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, Rr. Naïm Frasheri, lagjia 9, pall.47, shk.2, ap.29. Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr.027971456 leshuar me date 08.12.2009. Ne cilesine e Ortakut te vetem te Shoqerise "**BIGALB GROUP**" **Sh.p.k.**

i cili nenshkroi perpara meje (Akt – Themelimin, Statutin ) e perpiluar per themelimin e Shoqerise "**BIG TRENT**" **Sh.p.k.** Une noterja, pasi u binda se permbajtja e akteve te mesiperme ishte ne perputhje me vullnetin e tij te lire dhe bazuar ne ligjin shqiptar, e vertetoj ne baze te nenit 55 te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine"(i ndryshuar) dhe Udhezimit te Ministrise se Drejtesise, me cilesine qe me jep ligji.

**NOTERE**

**Albana HODAJ**

NOTERE  
ALBANA HODAJ  
Cel: 0682020790